



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

Nr. prot : 04 / 2026

RAPORTI FINANCIAR BUXHETOR I NPL – STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

**PËR PERIUDHËN 1 JANAR – 31 DHJETOR 2025 RAPORTI VJETOR PËR VITIN
2025 ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-087, MBI
MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË**



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

- Informata të përgjithshme..... 3.
- Përmbledhje Ekzekutive 4.
- Prezantimi 5.
- Pasqyra e strukturës organizative 6.
- Financat..... 8.
- Hyrjet dhe Shpenzimet 9.
- Humbje dhe Fitimi 14.
- Obligimi ndaj të gjithë palëve 15.
- Një mbishkrim mbi Ndërmarrjen..... 16.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Informatat e Përgjithshme

Emri i Ndërmarrjes :	Ndërmarrja Publike lokale Stacioni i Autobusëve Rahovec Sh.A
Pronar :	Kuvendi Komunal
Komisioni i Aksionerëve:	Perparim Krasniqi Eqrem Spahiu Merisa Sharku
Bordi i Drejtorëve :	Erlira Mullabazi Habib Shehu Myvlide Kafexhiu Fidan Gashi u.d Kryeshefi Ekzekutiv, Behar Gashi
Buxheti i Planifikuar 2025 :	67,698.00 €
Të Hyrat e 2025 :	63,107.77 €
Shpenzimet 2025 :	62,353.97 €
Numri i Peronave :	5
Numri i punëtoreve	7
Bilanci Gjinator	M- 5 / F- 2



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

Përmbledhja Ekzekutive

Stacioni i Autobusëve në Rahovec fillojë funksionimin si njësi punuese në vitin 1979 në kuadër të Ndërmarrjes për transport të udhëtareve dhe mallrave "Kosovatrans", me seli në Prizren. Më pas, ky Stacion u shndërrua dhe u themelua si "Ndërmarrje Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Rahovec Sh.A" më datën 13.08.2020.

Veprimtaria e tij ka qenë shërbyese, duke i përmbushur të gjitha elementet faktike dhe juridike, dhe vazhdon të kryhet me sukses edhe në ditët e sotme.

Stacioni i Autobusëve në Rahovec ka një objekt me sipërfaqe prej 294m², përfshirë këtu sallën e pritjes, zyrat administrative, sportelet, Restoranti dhe nyje sanitare dhe një objekt me 8 lokale afariste.

Në brendësi të tij, stacioni ka pistën (trasenë), peronat për kuqe te operatorëve në linjat sipas rendit të udhëtimit, me një sipërfaqe prej 1200m². Po ashtu, ka një lulishten me sipërfaqe prej 160m² dhe një hapësirë mbrapa objektit prej 1,288m².

Stacioni i Autobusëve kryen veprimtarinë shërbyese në ngastrën kadastrale nr. 1789-2, një pasuri komunale me një sipërfaqe prej 48,150.00 m².

Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndarë në dy sektorë: Administratë dhe Inkasim. Burimet kryesore të hyrave përfshijnë shërbimin e perionizimit, duke përfshirë pranimin dhe përcjelljen e autobusëve.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Prezantimi

Ky raport vjetor është ngritur mbi bazën e Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, nr. 03-L-087, nenin 31, pika 31.3. Ligji qartëson se brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, zyrtarët e Ndërmarrjeve Publike (NP) duhet të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtoreve të NP një raport vjetor për vitin e kaluar, duke përshkruar veprimet e ndërmarra. Ky proces është në përputhje me Nenin 14.1 dhe kërkon që raporti të përfshijë rezultatet financiare të arritura dhe efektshme rinë e përgjithshme në realizimin e qëllimeve të përcaktuara në Planin e Biznesit.

Raporti është një dokument i rëndësishëm që bazohet në detyrimet dhe përgjegjshmëritë ligjore të ndërmarrjes publike. Kjo shpjegon me qartë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti gjatë vitit 2025 për të arritur objektivat e parashtruara. Struktura organizative e ndërmarrjes, e prezantuar në këtë raport, është një element kryesor, pasi burimet njerëzore shihen si aset kryesor i çdo ndërmarrje. Pa këto burime, është e vështirë të realizohen synimet dhe objektivat e planifikuara.

Në këtë raport, do të hedhim dritë mbi performancën afariste dhe financiare të ndërmarrjes, Informacioni do të përfshijë detaje rreth të ardhurave, shpenzimeve dhe bilancit përfundimtar të suksesit të arritur gjatë vitit 2025. Ky analizë e hollësishme do të ofrojë një pamje të plotë mbi performancën dhe sjelljen e ndërmarrjes në periudhën e shqyrtuar.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Pasqyra e Strukturës Organizative e Ndërmarrjes

Organizimi i Ndërmarrjes paraqitet përmes një strukture hierarkike të përcaktuar me ligjet në fuqi, duke filluar nga Komisioni i Aksionarëve si organi më i lartë i mbikëqyrjes. Ky komision përcakton mekanizmat e nevojshëm për funksionimin sa më të mirë të ndërmarrjes dhe mban takime periodike, një herë në çdo 3 muaj, duke kontribuar me vlerësimin e tij në drejtimin e përgjithshëm të organizatës.

Bordi i Drejtorëve, si organ më i lartë pas Komisionit të Aksionarëve, zhvillon takime të rregullta një herë në muaj dhe, sipas nevojës, Drejtorët e Bordit bëjnë vizita periodike për të monitoruar me kujdes punën e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtarëve. Kontributi i Bordit të Drejtorëve në hartimin e planit buxhetor shënon një ndikim të jashtëzakonshëm, përfshirë vërejtje dhe sugjerime për përmirësim.

Veprimtaria shërbyese në fushën e transportit rrugor të udhëtareve ka karakteristika të veçanta, duke pasuar një lëvizje të pasagjerëve dhe operatorëve ekonomikë që nuk është konstante, por relative. Kjo kërkon një angazhim të veçantë dhe një qasje të adaptuar për të parashikuar me saktësi zhvillimet.

Në vitin 2025, numri i punëtorëve të punësuar ishte 7, me 5 meshkuj dhe 2 femra, duke pasuar një mesatare moshë prej 50.14 vitesh, megjithatë, pa përmbushur në tërësi skemën organizative të ndërmarrjes sipas ligjit në fuqi. Ky fakt sugjeron nevojën për një rishikim të strukturës organizative për të siguruar pajtueshmëri me detyrimet ligjore dhe efikasitetin e përgjithshëm të ndërmarrjes.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

4.Financat

NPL "Stacioni i Autobusëve Rahovec" sh.a. mbledh të hyrat e veta nga shërbimet e ndryshme të ofruara, duke u bazuar në statutin e ndërmarrjes:

- Shërbimi i Perionizimit: Ky shërbim është i disponueshëm për të gjithë operatorët e transportit të regjistruar në Kosovë, të cilët kanë linja të regjistruara dhe të lejuara nga Ministria e Infrastrukturës (MI) për linjat urbane, nder-urbane dhe ndërkombëtare.
- Shërbimi i Parkingut: Ndërmarrja posedon një hapësirë për parking të veturave private dhe autobusëve, megjithëse kjo hapësirë është e kufizuar.
- Lëshimi i Hapësirave Afariste me Qira: Ndërmarrja disponon 10 lokale, ku gjashtë (6) prej tyre janë lëshuar me qira gjatë këtij viti ndërsa 4 te tjera janë ne procedurë për dhënien me qira gjate vitit 2026, kjo për arsyeje teknike mos përfundimi apo kompletimi i vendosjes se njehsorëve elektrikë.

Për sigurimin e funksionimit efikas të ndërmarrjes, janë parashikuar shpenzime të ndryshme, përfshirë pagat dhe mëditjet e punëtorëve, pagat dhe mëditjet e anëtarëve të bordit dhe zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes. Po ashtu, janë evidentuar shpenzime operative dhe administrative, si dhe shpenzimet e amortizimit të ndërtesës së ndërmarrjes dhe pajisjeve të ndryshme që përdoren në operacionet e saj. Ky buxhet i parashikuar është bere ne përputhje me lokalet zejtare dhe është parashikuar ne mënyre qe te lëshohen me qira te gjithë lokalet andaj është me i larte se hyrjet real ne këtë vit.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Hyrje (Performanca Buxhetore)

Gjatë vitit 2025, performanca buxhetore e NPL "Stacioni i Autobusëve Rahovec" ka shënuar një rritje prej 22.47%, duke arritur në shifrën totale të 63,107.77 €, krahasuar me të hyrat e realizuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Kryesore për këtë, është kontributi i **shërbimit të perionizimit**, ku vlera e arritur është 48,171.70 €. Kjo shifër përfaqëson një normë ekzekutimi prej 76.33%, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të buxhetit për këtë kategori gjatë kësaj periudhe.

Te hyrat nga **qiraja** kanë arritur shumën prej 9,997.79€, duke mbuluar 15.84% të buxhetit të përgjithshëm për këtë kategori në këtë periudhë.

Nga ana tjetër, performanca nga **shërbimi i parkingut** të Autobusëve ka kontribuar me 3.828.50€, përmbajtja e së cilës përbën 6.07 % të buxhetit të përgjithshëm për këtë kategori.

Gjithashtu, të hyrat nga **Shërbime higjienike Publike** kanë arritur një shumë prej 464.40€, duke përformuar 0.74 % e buxhetit të përgjithshëm për këtë kategori në këtë periudhë.

Gjithashtu, të hyrat të cilat janë bartur nga viti paraprak (saldo) është bartur një shumë prej 645.38€, e cila ka rezultuar 1.02 % e buxhetit të përgjithshëm për këtë kategori në këtë periudhë.

Këto rezultate tregojnë performancën pozitive në menaxhimin buxhetor, duke e bërë ndërmarrjen në fokus për arritjen e qëllimeve financiare dhe operacionale në të ardhmen.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

- Të hyrat e realizuara nga këto aktivitete të ndërmarrjes janë të paraqitur në tabelën vijues:

Muaji	Viti – 2024	Viti – 2025
Saldo nga viti Paraprak	336.72 €	645.38 €
Janar	4.445.30 €	4.843.40 €
Shkurt	3.722.42 €	4.179.80 €
Mars	4.638.71 €	5.025.30 €
Prill	3.731.11 €	5.522.49 €
Maj	5.199.71 €	5.375.10 €
Qeshor	3.507.31 €	5.203.60 €
Korrik	3.593.51 €	5.080.90 €
Gusht	3.484.20 €	5.636.30 €
Shtator	4.378.81 €	5.394.00 €
Tetor	5.228.31 €	5.629.90 €
Nëntor	4.486.31 €	5.107.40 €
Dhjetor	4.776.51 €	5.464.20 €
Totali i të Hyrave	51,528.93 €	63,107.77 €



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Kategoritë e Shpenzimeve

Shpenzimet e përgjithshme janë të ndara në kategorinë e shpenzimeve për:

- Paga;
- Shpenzime operative;
- Shpenzimet administrative;

➤ Shpenzime për Paga

Sa i përket shpenzimeve të paga në kuadër të 'Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Rahovec Sh. A', identifikohen këto kategori:

- Kompensimi me pagë për Anëtarët e Bordit të Drejtoreve:
Anëtarët e Bordit të Drejtoreve të ndërmarrjes përfitojnë kompensim në bazë të vendimit të bordit. Paga për këtë kategori është përcaktuar në përputhje me buxhetin e ndërmarrjes e cila pagë është tejte e vogël me përgjegjësit.
- Kompensimi me pagë për Zyrtarët e Lartë:
Zyrtarët e lartë të ndërmarrjes marrin kompensim me pagë, i cili gjithashtu përcaktohet në bazë të vendimeve të bordit dhe kontratave individuale të punës.
- Kompensimi me pagë për Punëtorët e Ndërmarrjes:
Puna e punëtorëve të ndërmarrjes përfshin një kompensim të caktuar me pagë. Ky kompensim është i parashikuar dhe paguhet në bazë të kontratave të punës dhe vendimeve të bordit.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

Bordi, megjithatë, duke qenë në dijeni të vlerës së pagave në tregun aktual, bordi e ka ndjekur me kujdes situatën, dhe Bordi ka planifikuar të vazhdojë me rritjet në bazë të hyrave gjatë vitit në vazhdim për të përshtatur me mundësitë e tregut.

Megjithatë, është e rëndësishme theksuar se 'Ndërmarrja Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Rahovec Sh. A' po përballlet me disa shqetësime në lidhje me respektimin e Ligjit të Punës, duke mos i paguar punëtorët sipas disa kriterëve të caktuar:

- Përlllogaritja e përvojës së viteve të punës duke përfshirë një përlllogaritje vjetore me 0.5% mbi pagën bazë për çdo vit të punës.
- Përlllogaritja e një shtese prej 50% për ditët e punës gjatë festave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Këto çështje janë sfidat që janë adresuar në distanca më të larta si Komisioni i Aksionerëve, Kryetari i Kuvendit Komunal të Rahovecit dhe Kryetari i Komunës së Rahovecit nga bordi i ndërmarrjes në mënyrë që të sigurojë subvencionimin për rritjen e rrogave dhe zbatimin e plotë të Ligjit të Punës dhe të respektojë të drejtat dhe privilegjet e punëtorëve në përputhje me ligjin në fuqi.



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

- Të shpenzimet në paga gjatë viti 2025 janë këto aktivitete të ndërmarrjes ku janë të paraqitur në tabelën vijuese:

Pagat	Viti – 2024	Viti – 2025
<u>Pagat</u>	<u>34,394.49 €</u>	<u>41,848.06 €</u>
<u>Borgjet të Pagave</u>	<u>780,00 €</u>	<u>780,00 €</u>



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Shpenzime Operative

Shpenzimet operative përfshijnë të gjitha shpenzimet që lidhen me funksionalizimin e plotë të ndërmarrjes. Kjo kategori përfshin shpenzime të ndryshme, duke përfshirë shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e ujit, shpenzimet e mirëmbajtjes, si dhe shpenzime të tjera të paraqitura me detaje në tabelën e mëposhtme.

➤ Shpenzime në Administratë

Shpenzimet administrative përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me funksionalizimin administrativ të ndërmarrjes. Këto shpenzime përfshijnë materiale për zyre, shpenzime të ndryshme, dhe të tjera të cilat janë paraqitur me detaje në tabelën e mëposhtme.

Muaji	Viti – 2024	Viti – 2025
Janar	1.500.97	1.566.15
Shkurt	1.446.16	1.506.67
Mars	1.362.23	1.607.28
Prill	1.375.08	1.693.34
Maj	1.215.85	1.797.09



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

Qeshor	1,295.60	1,705.09
Korrik	1,163.05	1,767.91
Gusht	1.169.54	1.698.48
Shtator	1.172.19	1.747.06
Tetor	1.284.23	1.877.04
Nëntor	1.396.77	1.766.00
Dhjetor	1.427.39	1.773.80
<u>TOTALI</u>	<u>15,809.06</u>	<u>20,505.91</u>

Shpjegim: "NPL Stacioni i Autobusëve Rahovec" gjatë vitit 2025 i ka rritur shpenzimet për arsyeje se ka pasur rritje në Hyrje të ndërmarrjes andaj është rritur edhe pagesa për shpenzimin e TVSH-së.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Fitimi / Humbje

Të Ardhurat dhe Shpenzime gjithëpërfshirës	Viti – 2024	Viti – 2025
Të ardhurat gjithëpërfshirëse	51,528.93 €	63,107.77 €
Shpenzimet gjithëpërfshirëse	50,883.55 €	62,353.97 €
Saldo	645.38 €	753.80 €

Shpjegim: "NPL Stacioni i Autobusëve Rahovec" gjatë vitit 2025 ka regjistruar një hyrje më të madhe se viti paraprak për arsyeje të dhënies me qira të lokaleve zejtare dhe rritjes së çmimit të peronizimit.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Obligimet e ndërmarrjes ndaj te gjitha palëve

❖ Ndërmarrja ne vitin 2025 ka krijuar borxhe ndaj:

- **Tatimi në pronë** është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm **242.97 Euro**.
- **Taksa Komunale** është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm **00.00 €**.
- KRU – Gjakova nuk ka krijuar borxhe te reja **0.00 €**.
- Mbeturina nuk ka krijuar borgje **0.00 Euro**.
- **KEDS (Rryma)** është akumuluar borgj ne total te përgjithshëm **466.96€**.
- **PAGA** është akumuluar borgje ne vitin 2025 – **780.00€**.

Me totalin e përgjithshëm te borgjit prej 1,489.93 Euro.

❖ Ndërsa borgji total nga viti 2000 - 2024 është akumuluar :

- Tatimi në pronë është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm 4,729.46 Euro.
- Taksa Komunale është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm 1,527.50 €.
- KRU – Gjakova është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm 00.00 Euro.
- Mbeturina është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm 2,285.95 Euro.
- Paga e Neto te punëtoreve të vitit 2016 është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm 2.419.31 EUR.
- Paga Neto për vitin 2022 është akumuluar borgj me një total te përgjithshëm 1,430.00 EURO
- Rryma është akumuluar ne total prej 0.00 Euro.

Me totalin e përgjithshëm te borgjit prej 12,392.22 Euro



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SHA

➤ Një mbishkrim mbi Ndërmarrjen

Në vitin 2025, NPL Stacioni i Autobusëve Rahovec SHA shënoi një rrugëtim të mirë drejt normalizimit të gjendjes financiare dhe operative ku ka arritur të stabilizojë gjendjen e ndërmarrjes. Ky vit edhe pse ishte më i mirë se viti paraprak situata ekonomike e ndërmarrjes ka sfida të konsiderueshme, por është duke funksionuar.

Pika kryesore:

- **Vazhdimi i Zhvillimit:** ne fillim vitit 2026 parashihet të ketë stagnim ne procesin administrativ të NPL-se, ku parashihet me vendim te qeveris rritja e pagës minimale qe do shkaktonte mungesën e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve te NPL-së. Gjatë këtij viti, do të shpallen procedurat e mëtejshme për ankand publike dhe mundësitë e qiradhënies së këtyre lokaleve të cilat nuk janë lëshuar për shfrytëzim, duke ofruar mundësi të tjera për rritjen e të ardhurave dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik në ndërmarrje, nder tjera është procesi i instalimit te trafos.
- **Normalizimi Operativ:** Gjatë vitit 2025, NPL u përball me sfida në lidhje me normalizimin operativ, për shkak të pagave të ulëta dhe ankesave të vazhdueshme nga punonjësit, gjë te cilën pagën nuk e kane si tregu aktual i punes, megjithëse ka ende disa pakënaqësi viti është përmbyllur me suksese.
- **Sukseset:** Gjatë vitit 2025, kemi arritur të marrim në menaxhim të ndërmarrjes lokalet të cilat janë ndërtuar nga komuna, duke e marrë përsipër administrimin e këtyre lokaleve. Ky hap ka sjellë mundësinë për inkasimin e të ardhurave shtesë përmes menaxhimit të suksesshëm të pasurive të paluajtshme të NPL-së S.A
- **Normalizimi Financiar:** Në vitin 2025, NPL Stacioni i Autobusëve Rahovec SHA arriti të kthehet në rrugën e suksesit, duke normalizuar gjendjen financiare arsyjeja e këtij normalizimi është politika adekuate e bordit duke i funksionalizuar qiranë e 4 lokaleve, kjo ishte një shenjë e qartë e përmirësimit të drejtimin dhe menaxhimit të ndërmarrjes përkundrazi mungesës se njehsorëve elektrike.

u.d Kryeshefit Ekzekutiv
Behar Gashi